



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

UDHËZIM

Nr. 1 Datë: 21/05/2021

PËR FORMËN, ELEMENTËT DHE PLOTËSIMIN E LISTËPAGESËS MUJORE TË PAGAVE DHE TË URDHËR SHPENZIMIT PËR PAGAT NË NJËSITË E QEVERISJES SË PËRGJITHSHME

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, ligjit nr. 9936, datë 26/06/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 833, datë 28/10/2020, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit”, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe Departamenti i Administratës Publike,

UDHËZOJNË:

1. Forma e listëpagesës mujore të pagave për të punësuarit e njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme, të punësuarit me kontratë të përkohëshme pune të kontraktuar mbi numrin organik të njësive të qeverisjes së përgjithshme, si dhe për studentët dhe specializantët e sistemeve që kanë të tillë, përcaktohet në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Shpjegimi për secilin element të listëpagesës mujore të pagave, mënyra e plotësimit të saj dhe pagesa e të punësuarve me orë pune, përcaktohen në lidhjen nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.
3. Forma e urdhër shpenzimit për pagat e të punësuarve të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme, të punësuarit me kontratë të përkohëshme pune të kontraktuar mbi numrin organik të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme dhe për studentët dhe specializantët e institucioneve/sistemeve që kanë të tillë, përcaktohet në lidhjen nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

4. Shpjegimi për secilin element të urdhër shpenzimit të pagave dhe mënyra e plotësimit të tij, përcaktohen në lidhjen nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.
5. Shpjegimi për rrugën dhe hapat që duhen ndjekur për përgatitjen e listëpagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit të pagave, përcaktohen në lidhjen nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.
6. Përgjegjësitë dhe detyrat e institucioneve dhe përdoruesve të Regjistrit Qendror të Personelit (RQP) janë të përcaktuara në vendimin nr. 833, datë 28/10/2020, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit”.
7. Forma e urdhër shpenzimit dhe forma e listëpagesës mujore të pagave, të miratuara në këtë udhëzim janë të njëjta për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pavarësisht nëse ato i gjenerojnë këto dokumenta nëpërmjet RQP-së, ose jo.
8. Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore dhe vlerat e përcaktuara në to, të përmendura në lidhjet bashkëlidhur këtij udhëzimi, i referohen legjislacionit aktual në fuqi dhe ndryshojnë sa herë që ky legjislacion ndryshon.
9. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike dhe ministria e Financave dhe Ekonomisë të:
 - hartojnë planin e punës për institucionet/njësitë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme me qëllim gjenerimin nëpërmjet RQP-së, të listëpagesës mujore të pagave dhe urdhër shpenzimit përkatës të përcaktuara sipas këtij udhëzimi, si dhe dërgimin e tyre automatik elektronik në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ);
 - organizojnë trajnimet përkatëse për të gjithë përdoruesit, nëpërmjet Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, sipas përcaktimit të pikës 5, të vendimit nr. 833, datë 28/10/2020, të Këshillit të Ministrave.
10. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike të krijojë në RQP raporte të detajuara apo të përmbledhura për çdo element të listëpagesës mujore të pagave në nivel të të gjitha institucioneve, sistemeve ministrore apo për institucione të veçanta, sipas kërkesës së ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe/apo institucioneve.
11. Udhëzimi nr. 4 datë 13/12/2016 “Për formën, elementët dhe plotësimin e borderosë së pagave për njësitë e qeverisjes së përgjithshme” shfuqizohet.


Departamenti i Administratës Publike

Albana Koçiu



Ministri i Financave dhe Ekonomisë

Anila Denaj



LISTËPAGESA MUJORE E PAGAVE

LISTËPAGESA MUJORE E PAGAVE

- 1 Institucioni : Emri i plotë i institucionit
 2 Periudha : muaji viti
 3 Numri : 123546 4 Data : 02-04-2021

5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
Numër rendor	Emër Mbiemër	Emërtesa e pozicionit sipas strukturës së miratuar	Kategoria / Klasa / Funkzioni / Grada	Ditë pune (përfshirë dhe ditët e pushimit vjetor)	Paga e grupit	Paga bazë për klasë/gradë/shtesë ë pozicioni/shtesë fiksë për funksion/paga fiksë për titull	Paga bruto për ditët me raport mjekësor (deri 14 dite) që paguhen nga punëdhënësi	Shtesë për vjetërsi në punë/ në shërbim	Shtesë page për kualifikim shkencor	Shtesë kualifikimi për punonjësit mësimorë të arsimit parauniversitar	Shtesë page për natyrë të veçantë pune/kushte të veçanta shërbimi
- 1 -	- 2 -	- 3 -	- 4 -	- 5 -	- 6 -	- 7 -	- 8 -	- 9 -	- 10 -	- 11 -	- 12 -
1	a_Emër_Mbiemër	Specialist i Nive	IV-a	22	11,000	49,000	-	220	-	-	10,000
2	b_Emër_Mbiemër	Drejtor Drejtorie	II-b	22	14,000	100,000	-	7,000	-	-	10,000
3	c_Emër_Mbiemër	Arkivist	Klasa VII	22	-	36,300	-	4,356	-	-	-
4	d_Emër_Mbiemër	Shef Sektori i Ni	III-a/1	22	14,000	70,500	-	3,640	-	-	10,000
5	e_Emër_Mbiemër	Sanitar/pastrues/	Klasa I	22	-	30,000	-	7,500	-	-	-
6	f_Emër_Mbiemër	Sekretar	Klasa VIII	22	-	38,300	-	1,149	-	-	-
7	g_Emër_Mbiemër	Titullar Instituc	I-b	22	14,000	129,000	-	4,480	25,000	-	10,000
8	h_Emër_Mbiemër	Shofer	Klasa IV	22	-	33,400	-	1,336	-	-	-
Totali për punonjësit e miratuar në organikë					53,000	487,300	-	29,681	25,000	-	40,000
1	a_Emër_Mbiemër	Arkivist	Klasa VII	22	-	27,225	-	272	-	-	-
2	c_Emër_Mbiemër	Protokoll-arkiv	Klasa VII	17	-	21,038	5,728	210	-	-	-
Totali i punonjësve me kontratë të përkohshme mbi organikë					-	48,263	5,728	482	-	-	-
Totali për të gjithë punonjësit					53,000	535,563	5,728	30,163	25,000	-	40,000

BRUTO										
17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27
Shtesë page për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin	Shtesë page për funksion drejtues/shtesë për gradë	Shtesë page për orët mësimorë mbi normën e miratuar me dispozitë	Shtesë page për turne të dyta të treta	Shtesë page për orët jashtë kohës normale të punës	Shtesë page për kryerjen e shërbimit të rojes, të gadishmërisë dhe urgjencës	Shërbimi	Shtesë page për diferencë në rastet kur paga e muajit/ve paraardhës është llogaritur më pak	PAGA BRUTO MUJORE	Sigurimi vullnetar	Përjashtimi për të verbërit
- 13 -	- 14 -	- 15 -	- 16 -	- 17 -	- 18 -	- 19 -	- 20 -	- 21 -	- 22 -	- 23 -
-	-	-	-	-	-	-	-	70,220	-	-
-	-	-	-	-	-	-	-	131,000	-	-
5,340	-	-	-	-	-	-	-	45,996	-	-
-	-	-	-	-	-	-	-	98,140	-	-
5,340	-	-	-	-	-	-	-	42,840	-	-
-	-	-	-	-	-	-	-	39,449	-	-
-	-	-	-	-	-	-	-	183,280	-	-
-	-	-	-	-	-	-	-	34,736	-	-
10,680	-	-	-	-	-	-	-	645,661	-	-
4,005	-	-	-	-	-	-	-	31,502	-	-
3,095	-	-	-	-	-	-	-	30,071	-	-
7,100	-	-	-	-	-	-	-	61,573	-	-
17,780	-	-	-	-	-	-	-	707,234	-	-



NETO										
28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38
Sigurimi i detyrueshëm shoqëror	Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor	Sigurimi Suplementar	Tatimi mbi të Ardhurat Personale, në % mbi Pagën Bruto	Ndalesë page për masë disiplinore sipas legjisacionit në fuqi	Ndalesë page për cënimin ndaj institucionit sipas legjisacionit në fuqi	Ndalesë page për diferencë në rastet kur paga e muajit/ve paraardhës është llogaritur më shumë	Shuma e ndalesave	PAGA NETO MUJORE	Ndalesë për kuotizacion sindikate	Ndalesë për ekzekutim vendimi gjyqësor të formës së preni- përbarimi
- 24 -	- 25 -	- 26 -	- 27 -	- 28 -	- 29 -	- 30 -	- 31 -	- 32 -	- 33 -	- 34 -
6,671	1,194	2,107	5,229	-	-	-	15,201	55,019	-	-
10,894	2,227	5,240	13,130	-	-	-	31,491	99,509	-	-
4,370	782	-	2,079	-	-	-	7,231	38,765	-	-
9,323	1,668	3,926	8,858	-	-	-	23,775	74,365	-	-
4,070	728	-	1,669	-	-	-	6,467	36,373	-	-
3,748	671	-	1,228	-	-	-	5,647	33,802	-	-
10,894	3,116	7,331	23,254	-	-	-	44,595	138,685	-	-
3,300	591	-	616	-	-	-	4,507	30,229	-	-
53,270	10,977	18,604	56,063	-	-	-	138,914	506,747	-	-
2,993	536	-	195	-	-	-	3,724	27,778	-	-
2,857	511	-	9	-	-	-	3,377	26,694	-	-
5,850	1,047	-	204	-	-	-	7,101	54,472	-	-
59,120	12,024	18,604	56,267	-	-	-	146,015	561,219	-	-

Nëpunësi Autorizues
 39 (Emër Mbiemër)
 firma

Nëpunësi Zbatues
 40 (Emër Mbiemër)
 firma

41
 WULA

**SHpjegimi për Elementët e Listëpagesës Mujore
Të Pagave, Mënyra e Plotësimit të Saj,
Si dhe PAGESA E Të Punësuarve me Orë Pune të NjëSive
Shpenzuese të Qeverisjes së Përgjithshme**

I. HYRJE

Paga përfaqëson të ardhurat në para që punëdhënësi i jep punëmarrësit për punën e kryer në sasi, cilësi dhe kohë.

Paga përbëhet nga paga bazë dhe shtesat me karakter të përhershëm ose të përkohshëm, të miratuara me akte ligjore ose nënligjore, që përbën “Pagën bruto mujore” të të punësuarit. Nga paga bruto mujore zbritet: (i) kontributi i detyrueshëm i sigurimeve shoqërore e shëndetësore; (ii) kontributi i detyrueshëm i sigurimeve suplementare, për ata të punësuar që janë pjesë e skemave të sigurimit suplementar; (iii) tatimi mbi të ardhurat, dhe; (iv) mbajtje të tjera sipas legjislacionit në fuqi, sipas shpjegimeve më të hollësishme në këtë lidhje. Vlera që rezulton pas këtyre zbritjeve përbën “Pagën neto mujore” të të punësuarit, që zakonisht jepet një herë në muaj.

Paga bruto mujore e muajit përkatës, në kuptim të këtij udhëzimi, llogaritet si shumë e elementëve të përmendur në kolonat 6 - 20, që i punësuarit i përfiton në bazë të akteve ligjore/nënligjore në fuqi.

Paga neto mujore e muajit përkatës, në kuptim të këtij udhëzimi, llogaritet si diferencë e pagës bruto mujore (kolona 21) me shumën e ndalesave (kolona 31) dhe i gjenerohet të punësuarit në fillim të muajit pasardhës në llogarinë rrjedhëse në bankën përkatëse.

Të gjithë elementët si më sipër, pasqyrohen në listëpagesën mujore të pagës që shërben për llogaritjen e pagës bruto mujore dhe pagës neto mujore, me qëllim gjenerimin e pagës neto mujore në llogarinë rrjedhëse të të punësuarit, si dhe kryerjen nga punëdhënësi të pagesave të detyrimeve (mbajtjeve) për llogari të buxhetit të shtetit.

Listëpagesa mujore e pagave është një e vetme, si për të punësuarit sipas organikës së institucionit, ashtu edhe për ata të emëruar me kontratë të përkohëshme mbi numrin organik të punonjësve të institucionit, duke reflektuar fillimisht të punësuarit sipas organikës dhe më pas ata të emëruar me kontratë të përkohëshme.

Listëpagesa mujore e pagave përbëhet nga katër ndarje, si vijon:

- **Elementët e pagës bruto mujore dhe paga bruto mujore** – kolona 6 – kolona 21, e listëpagesës. Në këtë ndarje përfshihen të gjithë elementët që përbëjnë pagën bruto mujore, si dhe paga bruto mujore. Elementët e pagës bruto mujore dhe mënyra e përlllogaritjes së tyre shpjegohen në mënyrë më të hollësishme në ndarjen përkatëse të kësaj lidhjeje.
- **Përrjashtime nga tatimi mbi të ardhurat personale** – kolona 22 – kolona 23, e listëpagesës. Këta elementë shpjegohen në mënyrë më të hollësishme në ndarjen përkatëse të kësaj lidhjeje.

- **Ndalesat dhe paga neto mujore** – kolona 24 – kolona 32, e listëpagesës. Në këtë ndarje përfshihen të gjitha ndalesat që bëhen nga paga bruto mujore sipas legjislacionit në fuqi, si dhe paga neto mujore. Ndalesat, paga neto mujore, si dhe mënyra e përlllogaritjes së tyre shpjegohen në mënyrë më të hollësishme në ndarjen përkatëse të kësaj lidhjeje.
- **Mbajtje nga paga neto mujore për efekt të deyrimeve në legjislacione të tjera specifike** – kolona 33 – kolona 34, e listëpagesës. Mbajtjet nga paga neto mujore, si dhe llogaritja e pagës që i gjenerohet të punësuarit në llogarinë e tij bankare pas këtyre ndalesave shpjegohen në mënyrë më të hollësishme në ndarjen përkatëse të kësaj lidhjeje.

II. SHPJEGIME PËR LISTËPAGESËN MUJORE TË PAGAVE

ELEMENTËT E PAGËS BRUTO MUJORE DHE PAGA BRUTO MUJORE

1. Elementi nr. 1 i listëpagesës mujore të pagave - “Intitucioni”

- *Tekst dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (struktura-organika)!*

Kjo qelizë plotësohet automatikisht nga RQP-ja me emrin e plotë të institucionit për të cilin po gjenerohet listëpagesa mujore e pagave.

2. Elementi nr. 2 i listëpagesës mujore të pagave - “Periudha”

- *Tekst dhe plotësohet nga përdoruesit në momentin kur "Hap një periudhë page"!*

Kjo qelizë plotësohet nga përdoruesit dhe vendoset periudha kohore (muaji) për të cilën po gjenerohet listëpagesa e institucionit.

3. Elementi nr. 3 i listëpagesës mujore të pagave - “Numri”

- *Numër dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (moduli i pagave)!*

Kjo qelizë plotësohet automatikisht nga RQP-ja me numrin unik të listëpagesës mujore të pagave.

4. Elementi nr. 4 i listëpagesës mujore të pagave - “Data”

- *Datë dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (moduli i pagave)!*

Kjo qelizë plotësohet automatikisht nga RQP-ja me datën e listëpagesës mujore të pagave.

5. Elementi nr. 5 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 1 “Numër rendor”

- *Vlerë numerike që plotësohet automatikisht nga Regjistri Qendror i Personelit (moduli i pagave)!*

Në këtë qelizë RQP-ja vendos automatikisht një numër të plotë rendor të njëpasnjëshëm për secilin nga grupet e të punësuarve të institucionit (të punësuarit sipas organikës së institucionit edhe të emëruarit me kontratë të përkohëshme mbi numrin organik) duke filluar nga 1 dhe

mbaron me numrin e fundit, që përfaqëson totalin e numrit të të punësuarve për secilin nga grupet e të punësuarve, për të cilët do të gjenerohet paga e muajit.

6. Elementi nr. 6 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 2 “Emër Mbiemër”

- *Tekst dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (dosja personale)!*

Në këtë qelizë RQP-ja vendos automatikisht emrin dhe mbiemrin e të punësuarit të institucionit për të cilin po gjenerohet listëpagesa mujore e pagave.

7. Elementi nr. 7 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 3 “Emërtesa e pozicionit sipas strukturës së miratuar”

- *Tekst dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (struktura-organika)!*

Në këtë qelizë RQP-ja vendos automatikisht emërtesën e funksionit/pozicionit në të cilin është emëruar i punësuarit, sipas përcaktimit në strukturën dhe organikën e miratuar të institucionit, përfshirë të punësuarit me kontratë të përkohëshme mbi numrin organik.

8. Elementi nr. 8 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 4 “Kategoria/ Klasa/ Funksioni/ Grada/ Titulli”

- *Tekst dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (struktura-organika)!*

Në këtë qelizë RQP-ja vendos automatikisht “Kategorinë/Klasën/Funksionin/Gradën/Titullin” e pozicionit të punës së të punësuarit, që duhet të përputhet me kategorinë, klasën, funksionin apo gradën e përcaktuar në strukturën e miratuar të institucionit dhe/ose në vendimin përkatës të pagave.

9. Elementi nr. 9 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 5 “Ditë pune” (përfshirë edhe ditët e pushimit vjetor)

- *Element i pagës bruto mujore me vlerë numerike - plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (listë prezencë)!*

Në këtë qelizë ditët e punës së muajit për të cilin po gjenerohet paga reflektohen në mënyrë automatike nga RQP-ja, pasi njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ka plotësuar listë prezencën në RQP. Për efekt të zbatimit të vendimit nr. 511, datë 24/10/2002, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar ditët e punës do të konsiderohen 22 ditë në muaj (174 orë : 8 orë në ditë = 21.75 ditë).

Ditët e pushimeve vjetore të paguara përfshihen dhe llogariten në listëpagesë njësoj si ditët e punës.

Në rastin e muajve me 23 ditë pune dhe nëse i punësuarit ka raport apo leje me ose pa të drejtë page në përputhje me legjislacionin në fuqi për kohën e punës dhe të pushimit, të vendosur në kalendar, në sistem duhet hequr një ditë pune, zakonisht një nga ditët më të pafavorshme për të punësuarin, në mënyrë që paga mujore të dalë e saktë duke ju referuar 22 ditëshit.

Në rast se i punësuar ndryshon pozicionin e punës brenda të njëjtit muaj, në të njëjtin institucion apo në një institucion tjetër, për efekt të llogaritjes së pagës numri i ditëve të punës do të jetë si vijon:

- Numërohen ditët e punës në pozicionin ku i punësuar ishte në fillim të muajit;
- Ditët për pozicionin e ri ku i punësuar emërohet gjatë të njëjtit muaj, llogariten për diferencë të 22 ditëve në total me ditët e punuara në pozicionin e mëparshëm.

Kujdes:

Dita kur i punësuar fillon marrëdhënien financiare të punës dhe dita kur ai ndërpret marrëdhënien financiare të punës, konsiderohen ditë pune.

10. Elementi nr. 10 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 6 “Paga e grupit”

- *Element i pagës bruto mujore me vlerë numerike të llogaritur për ditë pune - plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (skema e pagave)!*
- *Referenca financiare 6001021*

Paga e grupit është element i pagës bruto mujore për nëpunësit civilë, si dhe për kategoritë e të punësuarve për të cilët elementët e pagës janë të njëjtë me elementët e pagës së nëpunësve civilë. Paga e grupit përfaqëson pagën për nivelin e diplomës. Përfituesit dhe vlera e pagës për nivelin e diplomës janë të përcaktuara në lidhje të veçanta në vendimet përkatëse të pagave.

11. Elementi nr. 11 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 7 “Paga bazë për klasë/ gradë/ shtesë pozicioni/ paga fikse për funksion/ paga fikse për titull”

- *Element i pagës bruto mujore me vlerë numerike të llogaritur për ditë pune - plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (skema e pagave)!*
- *Referenca financiare 6001001*

Paga bazë për klasë/gradë/shtesë pozicioni/paga fikse për funksion/paga fikse për titull është element i pagës bruto mujore për çdo të punësuar. Ajo është e diferencuar në bazë të funksionit/pozicionit/gradës/titullit që mban i punësuar dhe përcaktohet në legjislacionin përkatës me të cilin janë miratuar struktura dhe nivelet e pagave, në varësi të sistemit të pagave që përdoret. Vlera e pagës për këtë element page është e përcaktuar gjithashtu në vendimet përkatëse të pagave.

12. Elementi nr. 12 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 8 “Paga bruto për ditët me raport mjekësor (deri në 14 ditë) që paguhen nga punëdhënësi”

- *Element i pagës bruto mujore me vlerë numerike të llogaritur për ditët me raport - plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (listë prezenca)!*
- *Referenca financiare 6001002*

Paga bruto për ditët me raport mjekësor (deri në 14 ditë) që paguhen nga punëdhënësi është paga bruto që jepet në rastet kur të punësuarit janë me raport mjekësor për paaftësi të përkohëshme në punë deri në 14 ditë dhe paguhen nga punëdhënësi, në përputhje me nenin 130 të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1995, të ndryshuar, si dhe me nenin 25, të ligjit nr. 7703, datë 11/05/1993, të ndryshuar.

Kujdes:

Për ditët me raport deri në 14 ditë, për të cilat paga paguhet nga punëdhënësi, paga bruto për këto ditë llogaritet mbi pagën bruto mujore.

13. Elementi nr. 13 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 9 “Shtesë për vjetërsi në punë/në shërbim”

- *Element i pagës bruto mujore me vlerë numerike të llogaritur për ditë pune - plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (skema e pagave)!*
- *Referenca finaciare 6001003*

Shtesa për vjetërsi në punë/në shërbim është element i pagës bruto mujore që llogaritet në përqindje të ndryshme mbi pagën e grupit, pagën për klasë, pagën për gradë apo pagën fikse, për kategori të ndryshme të të punësuarve. Masa në përqindje dhe mënyra e përlllogaritjes përcaktohen në vendimin përkatës të pagave.

14. Elementi nr. 14 i listëpagesës mujore të pagave- kolona nr. 10 “Shtesë page për kualifikim shkencor”

- *Element i pagës bruto mujore me vlerë numerike të llogaritur për ditë pune - plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (dosja personale)!*
- *Referenca finaciare 6001008*

Shtesa e pagës për kualifikim shkencor është element i pagës bruto mujore i parashikuar në vlerë për kualifikimin shkencor që kanë të punësuarit. Në kualifikime shkencore përfshihen: studimet “Postmaster apo të barazvlefshëm me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë”, grada “Doktor i shkencave” dhe titujt “Profesor i Asociuar” e “Profesor”. Kjo shtesë është e parashikuar në vendimin nr. 187, datë 08/03/2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar. Kategoritë përfituese të kësaj shtese përcaktohen në Lidhjen 2/1 të këtij vendimi.

Kujdes:

*Kjo shtesë nuk duhet ngatërruar me **pagën bruto mujore** sipas gradave dhe titujve shkencorë që përfitojnë punonjësit kërkimorë shkencorë për të cilët aplikohet skema e pagës sipas gradave dhe titujve.*

Gjithashtu, kjo shtesë nuk aplikohet për të punësuarit për të cilët aplikohet skema e pagave sipas gradave e titujve shkencorë.

15. Elementi nr. 15 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 11 “Shtesë kualifikimi për punonjësit mësimorë të arsimit parauniversitar”

- *Element i pagës bruto mujore me vlerë numerike të llogaritur për ditë pune - plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (dosja personale)!*
- *Referenca finaciare 6001015*

Shtesa e kualifikimit për punonjësit mësimorë të arsimit parauniversitar është element i pagës bruto mujore i miratuar në vendimet përkatëse të pagave për punonjësit mësimorë të arsimit parauniversitar dhe për të punësuarit që punojnë në pozicionet nga “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit

parauniversitar. Kjo shtesë jepet sipas dëshmisë së kualifikimit individual dhe llogaritet mbi pagën e grupit, në përqindje, si vijon:

- a) për pozicionet nga “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, që trajtohen në pagë me vendimin nr. 187, datë 08/03/2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar:
 - i) 30% të pagës së grupit, mbas përfitimit të shkallës së tretë - “Mësues i kualifikuar”;
 - ii) 40% të pagës së grupit, mbas përfitimit të shkallës së dytë - “Mësues specialist”;
 - iii) 50% të pagës së grupit, mbas përfitimit të shkallës së parë - “Mësues mjeshtër”;
- b) për punonjësit mësimorë dhe drejtues në institucionet arsimore, që trajtohen në pagë me vendimin nr. 175, datë 08/03/2017, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar:
 - i) 5% të pagës së grupit, mbas përfitimit të shkallës “Mësues i kualifikuar”;
 - ii) 10% të pagës së grupit, mbas përfitimit të shkallës “Mësues specialist”;
 - iii) 20% të pagës së grupit, mbas përfitimit të shkallës “Mësues mjeshtër”.

16. Elementi nr. 16 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 12 “Shtesë page për natyrë të veçantë pune/kushte pune/kushte të veçanta shërbimi”

- *Element i pagës bruto mujore me vlerë numerike të llogaritur për ditë pune - plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (skema e pagave)!*
- *Referenca financiare 6001016*

Shtesa e pagës për natyrë të veçantë pune/kushte pune/kushte të veçanta shërbimi është element i pagës bruto mujore i parashikuar në vlerë dhe aplikohet për grupe të ndryshme të punësuarish: (i) nëpunës civilë, (ii) punonjës administrativë, (iii) punonjës që trajtohen në pagë sipas sistemeve me grada, (iv) punonjësit e sistemit të shëndetësisë, etj. Masa e shtesës dhe grupet e përfituesve përcaktohen në vendimet përkatëse të pagave me të cilat trajtohen në pagë të punësuarit.

17. Elementi nr. 17 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 13 “Shtesë page për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin”

- *Element i pagës bruto mujore me vlerë numerike të llogaritur për ditë pune - plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (skema e pagave)!*
- *Referenca financiare 6001017*

Shtesa e pagës për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin është element i pagës bruto mujore i parashikuar në disa vendime të Këshillit të Ministrave. Masa e shtesës është në vlerë absolute dhe jepet sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këto vendime.

Në rastet kur i punësuarit e përfiton shtesën për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 717, datë 23/06/2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar dhe, në rastet kur për ta duhet të aplikohen të katër shkallët e dëmshmërisë së shëndetit, masa e shtesës është e parashikuar në mënyrë të veçantë.

18. Elementi nr. 18 i listëpagesës mujore të pagave- kolona nr. 14 “Shtesë page për funksion drejtues/shtesë për gradë”

- *Element i pagës bruto mujore me vlerë numerike të llogaritur për ditë pune - plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (skema e pagave)!*
- *Referenca financiare 6001005*

Shtesa për funksion drejtues është element i pagës bruto mujore për një kategori të caktuar të punësuarish. Kjo shtesë është e parashikuar në përqindje mbi pagën bazë për klasë, e diferencuar në pesë grupime dhe aplikohet për të punësuarit që trajtohen në pagë sipas VKM-së nr.717, datë 23/06/2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, kur këta të fundit punojnë në pozicione drejtuese.

Shtesa për gradë është element i pagës bruto mujore për punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit. Kjo shtesë është e parashikuar në përqindje dhe aplikohet mbi pagën sipas gradës përkatëse që punonjësit e këtij shërbimi mbajnë, e miratuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e SHISH.

19. Elementi nr. 19 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 15 “Shtesë page për orët mësimore mbi normën e miratuar me dispozitë”

- *Element i pagës bruto mujore me vlerë numerike e llogaritur për orë mësimore - plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (skema e pagave)!*
- *Referenca financiare 6001018*

Shtesa e pagës për orët mësimore mbi normën e miratuar me dispozitë është element i pagës bruto mujore, e parashikuar në vlerë absolute dhe e miratuar me vendime të Këshillit të Ministrave, konkretisht si vijon:

- Vendimi nr. 748, datë 11/06/2009, i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar:
Anëtarët e personelit akademik efektivë, që për nevoja të procesit mësimor, japin orë mësimi mbi normën mësimore vjetore të miratuar me aktet përkatëse, për çdo orë mësimi të kryer mbi këtë normë, paguhen si më poshtë vijon:
 - Kur janë të kategorisë “Profesor” përfitojnë 1320 (një mijë e treqind e njëzetë) lekë për çdo orë 60 minutëshe;
 - Kur janë të kategorisë “Profesor i asociuar” përfitojnë 1210 (një mijë e njëqind e dhjetë) lekë për çdo orë 60 minutëshe;
 - Kur janë të kategorisë “Docent” përfitojnë 1100 (një mijë e njëqind) lekë për çdo orë 60 minutëshe;
 - Kur janë “Lektor i parë” përfitojnë 880 (tetëqind e tetëdhjetë) lekë për çdo orë 60 minutëshe;
 - Kur janë “Lektor” përfitojnë 660 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë për çdo orë 60 minutëshe.

Këto pagesa janë të njëjta për të gjitha institucionet shtetërore të arsimit të lartë që zbatojnë vendimin e sipërcituar.

- Vendimi nr.175, datë 08/03/2017, i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar:
Punonjësit mësimorë efektivë të arsimit parauniversitar, që për nevoja të procesit mësimor, japin orë mësimi mbi normën mësimore, të lejuar me dispozitë, paguhen për çdo orë mësimore si vijon:
 - Në shkollat e arsimit të mesëm të lartë - 350 lekë për orë;
 - Në shkollat e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët - 275 lekë për orë.

Në të njëjtën mënyrë trajtohen edhe mësuesit e shkollave tekniko - profesionale.

Sipas pikës 4, të VKM-së nr. 175/2017, të ndryshuar, edhe punonjësit e jashtëm të specialiteteve të ndryshme që japin mësim në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, në shkollat teknike e profesionale, si dhe në kurset e ndryshme (me përjashtim të kurseve që ngrihen pranë shkollave të larta dhe institucioneve të tjera të kualifikimit të punonjësve mësues), për çdo orë mësimore paguhen në të njëjtën masë me punonjësit mësues efektivë, si më sipër.

- Vendimi nr. 200, datë 15/03/2017, i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar:
Punonjësi i Policisë së Shtetit, që nuk është efektiv me kohë të plotë në institucionet e sistemit arsimor policor, por bashkëpunon me këto institucione si punonjës i jashtëm, për çdo orë mësimore 60 minutëshe, përfiton një page, si më poshtë vijon:
 - Në kurset e shkollimit/trajnimit për kursantët e nivelit zbatues, në masën 300 (treqind) lekë për orë;
 - Në kurset e shkollimit/trajnimit për kursantët e nivelit të parë drejtues, në masën 400 (katërqind) lekë për orë;
 - Në kurset e shkollimit/trajnimit për kursantët e nivelit të mesëm drejtues, në masën 500 (pesëqind) lekë për orë.

- Vendimi nr. 555, datë 11/08/2011, i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar:
Në rastet kur punonjësit e personelit mjekësor (me arsim të lartë) të **Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore**, marrin pjesë në veprimtaritë e trajnimit, (si për personelin mjekësor ashtu edhe për personelin paramedikal dhe publikun e gjerë) të cilat organizohen **nga vetë qendra**, për çdo orë mësimi 60 minutëshe përfitojnë trajtim me pagesë, si më poshtë:
 - trajnerët me më pak se 10 vite punë në profesion përfitojnë një pagesë prej 750 lekë për orë;
 - trajnerët me më shumë se 10 vite punë në profesion përfitojnë një pagesë prej 1500 lekë për orë.

Trajnerët të cilët janë punonjës të personelit mjekësor, (me arsim të lartë) të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, e përfitojnë këtë pagesë deri në 200 orë në vit.

Në rastet kur trajnerët janë bashkëpunëtorë të jashtëm nga Universiteti i Mjekësisë apo nga qendrat spitalore, pagesa për orë do të jetë e njëjtë me trajnerët e brendshëm të qendrës.

- Për institucione të tjera, që në legjislacionin e tyre kanë përcaktime të ndryshme nga sa sqaruar më sipër, zbatohet legjislacioni i tyre specifik.

20. Elementi nr. 20 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 16 “Shtesë page për turne të dyta/të treta”

- *Element i pagës bruto mujore me vlerë numerike të llogaritur për orë pune – plotësohet nga nëpunësi i financës!*
- *Referenca financiare 6001006*

Shtesa për turne të dyta/të treta është shtesë e parashikuar në përqindje mbi pagën bazë për klasë, e diferencuar sipas rastit kur të punësuarit orarin e tyre të punës e kanë të organizuar me turne.

Është një shtesë e parashikuar në ligjin nr. 7961, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku në nenin 79/1 dhe në nenin 81, të tij përcaktohet se:

Neni 79/1

Puna me turne (Shtuar me ligjin nr.136/2015)

“Punë me turne konsiderohet puna e kryer nga punëmarrësit që pasojnë njëri-tjetrin në të njëjtin vende pune, sipas një radhe të caktuar, në orare të ndryshme, gjatë një periudhe të caktuar ditësh ose javësh”.

Neni 81

“1. Çdo orë pune e kryer nga ora 19:00 deri në 22:00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 20 për qind.

Çdo orë pune e kryer midis intervalit 22:00 dhe 6:00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 50 për qind.”.

“Kur puna me turne organizohet pa ndërprerje edhe në ditët e pushimit javor dhe ditët e festave zyrtare, atëherë zbatohen përcaktimet e nenit 87 të Kodit të Punës.”.

“PUNA NË DITËN E DIEL OSE NE DITËT E FESTAVE

Neni 87

(Ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.3.1996)

(Ndryshuar me ligjin nr. 9125, datë 29.7.2003)

(Ndryshuar me ligjin nr. 136/2015)

1. Puna e kryer në ditën e pushimit javor kompensohet me një shtesë page, jo më pak se 25 për qind, ose me një pushim të pagueshëm, të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë, jo më pak se 25 për qind të kohëzgjatjes së kësaj pune.

2. Puna e kryer në ditët e festave zyrtare, kur ato bien ditë pune, kompensohet me një shtesë mbi pagë, jo më pak se 25 për qind dhe me një pushim të pagueshëm, të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer në ditët e festave zyrtare.”.

21. Elementi nr. 21 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 17 “Shtesë page për orët e punës jashtë kohës normale të punës”

- *Element i pagës bruto mujore me vlerë numerike të llogaritur për orë pune – plotësohet nga nëpunësi i financës!*
- *Referenca financiare 6001013*

Shtesa për orët e punës jashtë kohës normale të punës është shtesë e parashikuar në ligjin nr. 7961, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit dhe llogaritet në përqindje si vijon:

- Çdo orë shtesë tej orarit zyrtar, në ditë të zakonshme paguhet mbi pagën orare edhe me 25 për qind shtesë të kësaj page;

- Orët shtesë gjatë ditëve të pushimit apo ditëve të festave, si dhe çdo orë shtesë e kryer nga ora 22:00-6:00 paguhet mbi pagën orare edhe me 50 për qind shtesë të kësaj page.

22. Elementi nr. 22 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 18 “Shtesë page për kryerjen e shërbimit të rojës, të gadishmërisë dhe urgjencës”

- *Element i pagës bruto mujore me vlerë numerike të llogaritur për turne shërbimesh – plotësohet nga nëpunësi i financës!*
- *Referenca financiare 6001019*

Shtesa e pagës për kryerjen e shërbimit të rojës, të gadishmërisë dhe urgjencës është element i pagës bruto mujore, i parashikuar në bazë të vendimit nr. 555, datë 11/08/2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, për punonjësit e personelit mjekësor dhe të personelit të infermieristikës. Kjo shtesë jepet në rastet kur këta punonjës kryejnë shërbimin e rojës, kur qëndrojnë në gadishmëri, si dhe kur kryejnë shërbimin e urgjencës. Shtesa mbi pagë aplikohet në vlerë sipas përcaktimit të bërë në vendim dhe është e diferencuar, e konkretisht:

Për kryerjen e shërbimit të rojës, të gadishmërisë dhe urgjencës, të sistemit të ministrisë së Shëndetësisë, si dhe mjekëve, civilë e ushtarakë, të strukturave të Forcave të Armatosura u jepet shpërblim si më poshtë vijon:

a. Për mjekët:

- Për çdo shërbim rojë 24 orë pa ndërprerje:

Në qendrat spitalore universitare:	Mjek rojë i parë	Mjek rojë i dytë
për ditët e zakonshme	6 000 lekë	5 600 lekë
për ditët e shtuna	7 000 lekë	6 400 lekë
për ditët e diela e festat	8 000 lekë	7 600 lekë

Në institucionet e tjera:	Mjek rojë i parë	Mjek rojë i dytë
për ditët e zakonshme	5 000 lekë	5 200 lekë
për ditët e shtuna	6 000 lekë	5 600 lekë
për ditët e diela e festat	7 000 lekë	6 600 lekë

- Për shërbimin e urgjencës së rrethit, që është organizuar dhe funksionon si i tillë, për kohën që kryejnë shërbimin e urgjencës:

	Në ditët e zakonshme	Të shtuna	Të diela dhe festa
për sistemin 24 orë	2 300 lekë	2 400 lekë	2 700 lekë
për sistemin 16 orë	2 000 lekë	2 300 lekë	2 400 lekë
për sistemin 12 orë	1 800 lekë	2 000 lekë	2 300 lekë

- Kur thirren **për raste urgjence**, pasdite ose natën, nga mjeku i rojës së spitalit, për veprime diagnostikuese apo mjekuese, shpërblehen në masën 600 lekë deri në 1 000 lekë, në varësi të procedurës mjekësore që kryejnë. Këto shpërblime nuk mund të jenë më shumë se 20 për qind e pagës mujore për çdo muaj.

b. Për punonjësit e infermieristikës:

- Për punën e kryer nga ora 19:00 deri në 22:00 përfitojnë shtesë mbi pagë 120 lekë për çdo ditë, ndërsa për punën e kryer në intervalin 22:00 dhe 6:00 përfitojnë shtesë mbi pagë 500 lekë për çdo ditë.
- Për shërbimin e urgjencës së rrethit, që është organizuar dhe funksionon si i tillë, për kohën që kryejnë shërbimin e urgjencës, u jepet një shtesë në masën:

	Në ditët e zakonshme	Të shtuna	Të diela dhe festa
për sistemin 24 orë	1 700 lekë	2 100 lekë	2 500 lekë
për sistemin 16 orë	1 400 lekë	1 700 lekë	2 200 lekë
për sistemin 12 orë	1 100 lekë	1 400 lekë	1700 lekë

- c. Për rastet kur, me kërkesë të institucionit dhe miratim të ministrisë së Shëndetësisë dhe ministrisë së Mbrojtjes, laborantët e spitaleve kryejnë shërbim 24 orë, u jepet një shtesë, si më poshtë vijon:
- për ditë të zakonshme 1 300 lekë;
 - për ditët e shtuna 1 600 lekë;
 - për ditët e diela dhe festa 2 100 lekë.
- d. Për raste të veçanta, kur mjeku i rojës e sheh të domosdoshme thirrjen e personelit të infermieristikës për kryerjen e ekzaminimit apo të mjekimit, ky personel shpërblehet në masën 300 lekë deri në 750 lekë, për çdo rast. Këto shpërblime nuk mund të jenë më shumë se 20% e pagës mujore për çdo muaj.

23. Elementi nr. 23 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 19 “Shpërblimi”

- *Element i pagës bruto mujore me vlerë absolute numerike – plotësohet nga nëpunësi i financës!*
- *Referenca finaciare 6003100*

Shpërblimi është një shumë e tatushme, që i jepet të punësuarit:

- Në fund të vitit apo dhe në raste të tjera të veçanta gjatë vitit, sipas legjislacionit aktual në fuqi;
- Në rastet kur i punësuarit ka ndërprerë marrëdhënien e punës dhe nuk ka kryer pushimet vjetore që i takojnë. Në këtë rast, sipas pikës 5, të nenit 94, të Kodit të Punës, masa e shpërblimit është e barabartë me pagën e këtyre pushimeve të pakryera.

Ndërkohë kujtojmë se mbi shumën e shpërblimit në të dy rastet më sipër, nuk paguhet kontribut për sigurimet shoqërore e shëndetësore, (gërma “dh” e pikës 2, të kreut II “Paga për efekt të llogaritjes së kontributeve” të VKM-së nr.77/2015).

Kujdes:

Në këtë kolonë nuk do të përfshihen shpërblimet e marra për rastet e sëmundjeve apo fatkeqësive, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe dispozitave nënligjore në fuqi, me përjashtim të rasteve kur masa e këtyre shpërblimeve është më e madhe se 20% e të ardhurave vjetore nga punësimi të punonjësit përfitues të shpërblimit.

24. Elementi nr. 24 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 20 “Shtesë page për diferencë në rastet kur paga e muajit/ve paraardhës është llogaritur më pak”

- *Element me vlerë numerike absolute dhe plotësohet nga nëpunësi i financës për efekte korrigjuese!*

Shtesa e pagës për diferencë është një shtesë që i jepet të punësuarit në rastet kur paga e muajit apo disa muajve paraardhës është llogaritur më pak se sa ai duhet të merrte, e dokumentuar zyrtarisht. Në këtë rast, diferenca e llogaritur midis pagës bruto mujore që duhet të përfitonte punëmarrësi me pagën bruto mujore që realisht ka përfituar, vendoset në këtë kolonë për të mos u ngatërruar me elementët e tjerë të shtesave mbi pagë.

25. Elementi nr. 25 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 21 “Paga Bruto”

- *Element me vlerë numerike - llogaritet nga Regjistri Qendror i Personelit (moduli i pagave)!*

Është paga bruto mujore gjithsej nga punësimi gjatë muajit përkatës dhe llogaritet si shumë e elementëve të përmendur në kolonat 6 - 20, të cilat i punësuarit i përfiton në bazë të akteve ligjore/nënligjore në fuqi.

Kujdes:

Në këtë pagë përfshihet edhe paga për paaftësi të përkohshme në punë deri në 14 ditë kalendarike, që paguhet nga punëdhënësi.

PËRJASHTIME NGA TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE

26. Elementi nr. 26 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 22 “Sigurimi vullnetar”

- *Element me vlerë numerike – plotësohet nga nëpunësi i financës!*

Në këtë qelizë reflektohet vlera e kontributit të sigurimit vullnetar, deri në masën e përcaktuar në ligjin për fondet e pensionit vullnetar, bazuar në kontratën që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit të pensionit vullnetar. Këtë vlerë, RQP-ja, për efekt të llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale do ta zbresë nga paga bruto.

Baza ligjore për këtë është si vijon:

- Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, përcakton se kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi të pensionit vullnetar, deri në masën e përcaktuar në ligjin për fondet e pensionit vullnetar, si dhe kontributet e bëra nga punëdhënësi ose çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogaritjen të anëtarit të fondit, është e ardhur e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale.

- Në udhëzimin e ministrisë së Financave dhe Ekonomisë përcaktohet se pagesa e bërë nga vetë anëtari në fondin e pensionit vullnetar, deri në masën e përcaktuar në ligjin për fondet e pensioneve vullnetare, e parashikuar në kontratën që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit, është e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale. Kjo pagesë i zbritet të ardhurës personale të tatueshme, përpara përlllogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale. Dokumenti justifikues është kontrata që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit të pensionit vullnetar.

27. Elementi nr. 27 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 23 “Përjashtimi për të verbërit”.

- *Element me vlerë numerike – plotësohet nga nëpunësi i financës!*

Në këtë qelizë reflektohet vlera e pagës bruto të të verbërit. Këtë vlerë, RQP-ja, për efekt të llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale do ta zbresë nga paga bruto dhe, si rrjedhim, tatimi i të ardhurave personale të tij është zero.

Baza ligjore për këtë është si vijon: Në nenin 4, të ligjit nr.8098, datë 28/03/1996, “Për statusin e të verbërit”, përcaktohet se të verbërit përjashtohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur ata kryejnë veprimtari private si persona juridikë.

NDALESAT DHE PAGA NETO MUJORE

28. Elementi nr. 28 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 24 “Sigurimi i detyrueshëm shoqëror”

- *Element i ndalesave nga paga bruto mujore, me vlerë numerike - llogaritet nga Regjistri Qendror i Personelit (moduli i pagave) bazuar në legjislacionin që mbulon sigurimet shoqërore!*
- *Referenca financiare 6010100*

Sigurimi i detyrueshëm shoqëror përfaqëson shumën e kontributit që paguan i punësuar (pra atë pjesë që i mbahet nga paga bruto mujore në formën e ndalesës) për sigurimin për sëmundje, barrë lindje, pensione. Kontributi i detyrueshëm i sigurimit shoqëror mbahet në burim nga punëdhënësi për të punësuarin, sipas masës në përqindje të përcaktuar në legjislacion.

- Masa në përqindje aplikohet mbi vlerën e:

(i) kufirit minimal të pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, përcaktuar në vendimin nr.77/2015 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në rastin kur paga bruto mujore është më e vogël se sa ky kufi.

(ii) kufirit maksimal të pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, përcaktuar në vendimin nr.77/2015 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në rastin kur paga bruto mujore është më e madhe se sa ky kufi.

(iii) pagës bruto mujore në rastet kur paga është brenda kufirit minimal dhe maksimal të pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, përcaktuar në vendimin nr.77/2015 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

- Në rastet kur të punësuarit kanë më pak se 22 ditë pune dhe për këtë shkak ***paga bruto mujore për atë muaj llogaritet të jetë më e vogël se kufiri minimal i pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve të detyrueshme shoqërore***, masa në përqindje aplikohet sipas rregullave si vijon:
 - (i) Kur paga bruto mujore për muajin e dhënë, llogaritet të jetë më e vogël se kufiri minimal i pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, *për shkak të raporteve mjekësore deri në 14 ditë*, masa në përqindje aplikohet mbi vlerën e pagës bruto mujore të llogaritur për atë muaj;
 - (ii) Kur paga bruto mujore për muajin e dhënë, llogaritet të jetë më e vogël se kufiri minimal i pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, *për shkak se i punësuarit ka filluar punë rishtazi në atë muaj*, masa në përqindje aplikohet mbi vlerën e pagës bruto mujore të llogaritur për atë muaj;
 - (iii) Kur paga bruto mujore për muajin e dhënë, llogaritet të jetë më e vogël se kufiri minimal i pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, *për shkak se i punësuarit ka përfunduar marrëdhënien e punës në atë muaj*, masa në përqindje aplikohet mbi vlerën e pagës bruto mujore të llogaritur për atë muaj;
 - (iv) Kur paga bruto mujore për muajin e dhënë, llogaritet të jetë më e vogël se kufiri minimal i pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, *për shkak se i punësuarit ka marrë leje pa të drejtë page në atë muaj*, masa në përqindje aplikohet mbi kufirin minimal të pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore.
- Aktualisht, sipas përcaktimit të vendimit nr. 77/2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar:
 - Kufiri minimal i pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve të detyrueshme shoqërore është 30,000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj;
 - Kufiri maksimal i pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve të detyrueshme shoqërore është 132,312 (njëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë në muaj.

Kujdes:

Në pagën bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve të detyrueshme shoqërore nuk përfshihen shpërblimet me karakter jo të përhershëm, të lejuara në mbështetje të legjislacionit në fuqi, shpërblimet nga fondi i veçantë, dhënie e ndihmave për rastet e fatkeqësive në familje, për sëmundjet e gjata, për dëme, në raste fatkeqësish të mëdha natyrore, dhe për veprimtari të shquara.

29. Elementi nr. 29 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 25 “Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor”

- *Element i ndalesave nga paga bruto mujore, me vlerë numerike - llogaritet nga Regjistri Qendror i Personelit (moduli i pagave) bazuar në legjislacionin që mbulon sigurimet shëndetësore!*
- *Referenca financiare 6011100*

Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor përfaqëson shumën e kontributit që paguan i punësuar (pra atë pjesë që i mbahet nga paga bruto mujore në formën e ndalesës) për sigurimin shëndetësor. Kontributi i detyrueshëm i sigurimit shëndetësor mbahet në burim nga punëdhënësi për të punësuarin, sipas masës në përqindje të përcaktuar në legjislacion.

- Masa në përqindje aplikohet mbi vlerën e:
 - (i) kufirit minimal të pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shëndetësore, përcaktuar në vendimin nr.77/2015 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në rastin kur paga bruto mujore është më e vogël se sa ky kufi.
 - (ii) pagës bruto mujore, në rastet kur paga është më e madhe se kufiri minimal i pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shëndetësore, përcaktuar në vendimin nr.77/2015 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.
- Në rastet kur të punësuarit kanë më pak se 22 ditë pune dhe për këtë shkak ***paga bruto mujore për atë muaj llogaritet të jetë më e vogël se kufiri minimal i pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shëndetësore***, masa në përqindje aplikohet sipas rregullave si vijon:
 - (i) Kur paga bruto mujore për muajin e dhënë, llogaritet të jetë më e vogël se kufiri minimal i pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shëndetësore, *për shkak të raporteve mjekësore deri në 14 ditë*, masa në përqindje aplikohet mbi vlerën e pagës bruto mujore të llogaritur për atë muaj;
 - (ii) Kur paga bruto mujore për muajin e dhënë, llogaritet të jetë më e vogël se kufiri minimal i pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shëndetësore, *për shkak se i punësuar ka filluar punë rishtazi në atë muaj*, masa në përqindje aplikohet mbi vlerën e pagës bruto mujore të llogaritur për atë muaj;
 - (iii) Kur paga bruto mujore për muajin e dhënë, llogaritet të jetë më e vogël se kufiri minimal i pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shëndetësore, *për shkak se i punësuar ka përfunduar marrëdhënien e punës në atë muaj*, masa në përqindje aplikohet mbi vlerën e pagës bruto mujore të llogaritur për atë muaj;
 - (iv) Kur paga bruto mujore për muajin e dhënë, llogaritet të jetë më e vogël se kufiri minimal i pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shëndetësore, *për shkak se i punësuar ka marrë leje pa të drejtë page në atë muaj*, masa në përqindje aplikohet mbi kufirin minimal të pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shëndetësore.
- Aktualisht, sipas përcaktimit të vendimit nr. 77/2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, kufiri minimal i pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shëndetësore është 30.000 (tridhjetëmije) lekë në muaj.

30. Elementi nr. 30 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 26 “Sigurimi Suplementar”

- *Element i ndalesave nga paga bruto mujore, me vlerë numerike - llogaritet nga Regjistri Qendror i Personelit (moduli i pagave) bazuar në legjislacionin që mbulon sigurimet shoqërore!*

- Sigurimi suplementar përfaqëson shumën e kontributit që paguan i punësuar (pra atë pjesë që i mbahet nga paga bruto mujore në formën e ndalesës) për sigurimin suplementar në bazë të legjislacionit në fuqi në këtë fushë. Është element i ndalesave nga paga bruto mujore dhe përlllogaritet në përqindje ndaj pagës bruto mujore apo pagës referuese për këtë qëllim, i diferencuar sipas kategorive të përfituesve.
- Në rastet kur të punësuarit kanë më pak se 22 ditë pune dhe për këtë shkak **paga bruto mujore për atë muaj llogaritet të jetë më e vogël se kufiri minimal i pagës bruto mujore për efekt të llogaritjes së kontributeve suplementare të detyrueshme**, zbatohen të njëjtat rregulla si në rastin e kontributeve të sigurimeve shëndetësore.
- Referuar pikës 5, të kreut II, të vendimit nr.77/2015 të Këshillit të Ministrave paga bruto mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve suplementare të detyrueshme, është nga 30.000 (tridhjetmijë) lekë deri në shumën e pagës bruto mujore sipas listëpagesës.
- Për sisteme të tjera që në legjislacionin e tyre specifik kanë përcaktime të ndryshme, zbatohet legjislacioni i tyre specifik.

31. Elementi nr. 31 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 27 “Tatimi mbi të ardhurat personale në përqindje mbi pagën bruto mujore”

- *Element i ndalesave nga paga bruto mujore, me vlerë numerike - llogaritet nga Regjistri Qendror i Personelit (moduli i pagave) bazuar në legjislacionin tatimor!*

“Tatimi mbi të ardhurat personale në përqindje mbi pagën bruto mujore” është shuma e tatimit mbi të ardhurat që mbahet në burim dhe nënkupton shumën që të punësuarit janë të detyruar të paguajnë, nisur nga të ardhurat që sigurojnë nga pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës.

Shuma e tatimit mbi të ardhurat llogaritet në përqindje ndaj pagës bruto mujore, e diferencuar sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës tatimor, aktualisht ligji nr. 8438, datë 28/12/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe që tregohet në tabelën e mëposhtme.

Për efekt të llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale, nëse paga bruto mujore do të jetë deri në 30.000 lekë në muaj, tatimi do të jetë zero lekë në muaj, nëse paga bruto e tejkalon shumën 30.000 lekë në muaj, do të zbatohen përqindjet e miratuara në legjislacionin tatimor sipas tabelës shpjeguese të ligjit.

E ardhura e tatueshme (në lekë/muaj)		
Nga	Deri në (përfshirë)	Përqindje
0	30.000	Zero për qind
30.001	150 000	+13 për qind të shumës mbi 30 000 lekë.
150 001	Më tepër	15 600 lekë + 23 përqind të shumës mbi 150 000 lekë.

Në rast se i punësuar ndryshon pozicionin e punës brenda periudhës një mujore, brenda të njëjtit institucion, llogaritjet e tatimit mbi të ardhurat do të bëhen mbi pagën bruto mujore të shumës së dy pozicioneve.

Në rast se i punësuar ndryshon pozicionin e punës brenda periudhës një mujore dhe koha e punës ndahet në institucione të ndryshme, llogaritjet e tatimit mbi të ardhurat do të bëhen mbi pagën bruto mujore në secilin institucion.

32. Elementi nr. 32 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 28 “Ndalesë page për masë disiplinore sipas legjislacionit në fuqi”.

- *Element i ndalesave nga paga bruto mujore, me vlerë numerike - llogaritet nga Regjistri Qendror i Personelit (moduli i pagave), bazuar në legjislacionin e shërbimit civil!*

Në këtë kolonë përfshihet detyrimi që mund të ketë i punësuar ndaj institucionit kur, ndaj tij është marrë masë disiplinore me mbajtjen e një pjese të pagës, sipas ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

33. Elementi nr. 33 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 29 “Ndalesë page për çdëmtim ndaj institucionit sipas legjislacionit në fuqi”

- *Element i ndalesave nga paga bruto mujore, me vlerë numerike absolute - llogaritet nga Regjistri Qendror i Personelit (moduli i pagave)!*

Në këtë kolonë përfshihet detyrimi që mund të ketë punëmarrësi ndaj institucionit kur, ndaj tij është marrë vendimi i çdëmtimit të institucionit në vlerë, për të gjitha rastet kur punëmarrësi i ka shkaktuar një dëm institucionit, e dokumentuar zyrtarisht dhe ndaj të cilit kanë vendosur organet kompetente.

34. Elementi nr. 34 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 30 “Ndalesë page për diferencë në rastet kur paga e muajit/muajve paraardhës është llogaritur më shumë”

- *Element i ndalesave nga paga bruto mujore, me vlerë numerike absolute - plotësohet nga nëpunësi i financës për efekte korigjuese!*

Është një ndalesë që i mbahet të punësuarit në rastet kur paga bruto e muajit apo disa muajve paraardhës është llogaritur më shumë se sa ai duhet të merrte, e dokumentuar zyrtarisht. Në këtë rast, diferenca e llogaritur midis pagës bruto mujore që duhet të përfitonte punëmarrësi me pagën bruto mujore që realisht ka përfituar, vendoset në këtë kolonë për të mos u ngatërruar me elementët e tjerë të ndalesave nga paga.

35. Elementi nr. 35 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 31 “Shuma e ndalesave”

- *Element me vlerë numerike - llogaritet nga Regjistri Qendror i Personelit (moduli i pagave)!*

Në këtë kolonë përfshihet shuma e ndalesave që mbahen nga paga (kolonat nga 24 deri në 30).

36. Elementi nr. 36 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 32 “Paga Neto Mujore”

- *Element me vlerë numerike - llogaritet nga Regjistri Qendror i Personelit (moduli i pagave)!*

Paga neto mujore llogaritet si diferencë e pagës bruto mujore (kolona 21) me shumën e ndalesave (kolona 31).

MBAJTJE NGA PAGA NETO PËR EFEKT TË DEYRIMEVE NË LEGJISLACIONE TË TJERA SPECIFIKE

37. Elementi nr. 37 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 33 “Ndalesë për kuotizacion sindikate”

- *Element i ndalesave nga paga neto mujore me vlerë numerike - plotësohet automatikisht nga Regjistri Qendror i Personelit (moduli i pagave)!*

Në këtë qelizë vendoset vlera që i punësuari ka autorizuar me shkrim punëdhënësin që të mbajë nga paga e tij neto, për efekt të kuotizacionit për anëtarësim në sindikatë.

Punëdhënësi derdh:

- *në një bankë të nivelit në llogarinë bankare të sindikatës ku është anëtarësuar i punësuari, vlerën e ndalesave të llogaritur në këtë qelizë;*
- *në llogarinë bankare të të punësuarit, vlerën që llogaritet si diferencë e pagës neto mujore me vlerën e ndalesës për kuotizacion sindikate.*

Baza ligjore për këtë është si vijon:

Në nenin 117/ 2, të Kodit të Punës, përcaktohet se punëdhënësi vetëm me autorizim me shkrim nga punëmarrësi mund të zbresë nga paga kuotizacionet sindikale. Çdo muaj, punëdhënësi zbret nga paga neto e punëmarrësit kuotizacionin sindikal, të cilin e xhiron (kalon) në një bankë të nivelit të dytë dhe në llogarinë përkatëse të sindikatës ku është anëtarësuar punëmarrësi.

38. Elementi nr. 38 i listëpagesës mujore të pagave - kolona nr. 34 “Ndalesë për ekzekutim vendimi gjyqësor të formës së prerë - përmbarimi”

- *Element i ndalesave nga paga neto mujore me vlerë numerike - plotësohet automatikisht nga Regjistri Qendror i Personelit (moduli i pagave)!*

Në këtë qelizë vendoset vlera që duhet t’i mbahet nga paga neto mujore të punësuarit, për shkak të detyrimit që ky i fundit ka ndaj një pale të tretë, bazuar kjo në dokument të dërguar nga një përmbarues.

Punëdhënësi derdh:

- *në një bankë të nivelit të dytë në llogarinë bankare të përmbaruesit, vlerën e ndalesës së llogaritur në këtë qelizë;*
- *në llogarinë bankare të të punësuarit, vlerën që llogaritet si diferencë e pagës neto mujore me vlerën e ndalesës për ekzekutim të vendimit gjyqësor.*

Baza ligjore për këtë është neni 533, i Kodit të Procedurës Civile.

39. Elementi nr. 39 i listëpagesës mujore të pagave, “Nëpunësi Autorizues”

- *Tekst dhe plotësohet nga nëpunësi i financës!*

Vendoset Emër Mbiemër i Nëpunësit Autorizues të institucionit dhe firma (autoriteti që ka depozituar firmën në degën e thesarit si nëpunës autorizues)

40. Elementi nr. 40 i listëpagesës mujore të pagave, “Nëpunësi Zbatues”

- *Tekst dhe plotësohet nga nëpunësi i financës!*

Vendoset Emër Mbiemër i Nëpunësit Zbatues të institucionit dhe firma (autoriteti që ka depozituar firmën në degën e thesarit si nëpunës zbatues)

41. Elementi nr. 41 i listëpagesës mujore të pagave, “Vula”

- *Vula dhe plotësohet nga institucioni!*

Vendoset vula institucionit.

PËR PUNONJËSIT E PUNËSUAR ME KONTRATË TË PËRKOHËSHME PUNE

Të punësuarit me kontratë të përkohëshme pune trajtohen me pagë orare në bazë të orëve të punës të kryera gjatë muajit.

1. Për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror e shëndetësor, do të zbatohet vendimi nr.77, datë 28/01/2015, i Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sistemi i sigurimit shëndetësor”, i ndryshuar. Sipas këtij vendimi, kontributet për sigurimin e detyrueshëm shoqëror e shëndetësor do të paguhën si vijon:
 - Kontributi i detyrueshëm për të punësuarit me kontratë të përkohëshme pune, që zgjat më shumë se 87 orë në muaj, të jetë:
 - a. për sigurimet shoqërore, 24.5% të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 15.0% dhe pjesa e të punësuarit 9.5%, por jo më pak se paga minimale dhe jo më shumë se paga maksimale, e përcaktuar në këtë vendim, për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore;
 - b. për sigurimin e kujdesit shëndetësor, 3.4% të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 1.7% dhe pjesa e të punësuarit 1.7%, por jo më pak se paga minimale, e përcaktuar në këtë vendim, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor.
 - Kontributi i detyrueshëm për të punësuarit me kontratë të përkohëshme pune, që zgjat më pak se 87 orë në muaj, të jetë:
 - a. për sigurimet shoqërore, 23.3% të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 13.92% dhe pjesa e të punësuarit 9.38%, por jo më pak se paga minimale dhe jo më

shumë se paga maksimale, e përcaktuar në këtë vendim, për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore;

- b. për sigurimin e kujdesit shëndetësor, 3.4% të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 1.7% dhe pjesa e të punësuarit 1.7%, por jo më pak se paga minimale e përcaktuar në këtë vendim, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor.
- Kontributi i detyrueshëm për të punësuarit me kontratë të përkohëshme pune, që zgjat më pak se 1 javë, të jetë:
 - a. për sigurimet shoqërore, 0.3% të pagës bruto, të realizuar gjatë ditëve të punës dhe përballohet nga punëdhënësi;
 - b. për sigurimin e kujdesit shëndetësor, 3.4% të pagës bruto, të realizuar gjatë ditëve të punës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 1.7% dhe pjesa e të punësuarit 1.7%.
2. Për efekt të llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale, nëse paga bruto mujore do të jetë deri në 30.000 lekë në muaj, tatimi do të jetë zero lekë në muaj, nëse paga bruto mujore e tejkalon shumën 30.000 lekë në muaj, do të zbatohen përqindjet e miratuara në legjislacionin tatimor, sipas tabelës shpjeguese të ligjit, sqaruar në Kolonën nr. 27 “Tatimi mbi të ardhurat personale në përqindje mbi pagën bruto”.

URDHËR SHPENZIMI

Institucioni	① Emri i institucionit
NIPT-i	② NIPT-i i institucionit
Kodi i Institucionit	③ Kodi i institucionit
Entiteti i Qeverisjes	④ Kodi i entitetit
Distrikti (TDO)	⑤ Distrikti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
REGJISTRI QENDROR
I PERSONELIT

Numri i Kuponit: ⑥ 123456789

URDHËR - SHPENZIMI

Nr: ⑦ 12345 ⑧ HRMIS_12345

Date: ⑨ 01.01.2020

Numri i punonjësve
të miratuar në organikë

Plan: ⑩ 12

Fakt: ⑪ 10

Numri i punonjësve
mbi numrin organik (me kontratë)

Plan: ⑫ 5

Fakt: ⑬ 3

⑭ NR.	Struktura buxhetore						⑳ Kodi projektit	㉑ Shuma në lekë	㉒ Objekti i Shpenzimit
	⑮ Grupi	⑯ Kapitulli	⑰ Kodi Programit	⑱ Llogaria ekonomike	⑲ Nën llogaria	⑳ Kodi projektit			
1	87	01	01130	600	6001001	98702AA	506,747	㉓ Paga neto për punonjësit e miratuar në organikë	
2	87	01	01130	600	6002001	98702AA	54,472	㉔ Paga neto e punonjësve me kontratë të përkohëshme mbi numrin organik	
Totali në shifra: ㉕ 561,219									
Totali me fjale: ㉖ shifra e totalit me fjale									

Të dhëna për kreditorin përfitues:	
Emri i Përfituesit:	Emri i përfituesit ㉗
NIPT-i	㉘
Numri i llogarisë bankare	㉙

Emri i Bankës	㉚
Adresa e Bankës	㉛
IBAN:	㉜

Dokumentat bashkëngjitur urdhër shpenzimit:		
Emërtimi	Nr. Dokumenti	Datë Dokumenti
Çek	㉝	㉞
Xhirim	㉟	㊀

Emërtimi	Nr. Dokumenti	Datë Dokumenti
Listë pagesa mujore	㊁ numër 1234256	㊂ 12/10/2021
Listë pagesa për bankën	㊃ numër 123456	㊄ 12/10/2021

PËR INSTITUCIONIN

Nëpunësi AUTORIZUES

① (Emër Mbiemër)

firma

③

Vula:

Nëpunësi ZBATUES

② (Emër Mbiemër)

firma

④

Vula:

PËR DEGËN E THESARIT

NËPUNESI I THESARIT

④ (Emër Mbiemër)

firma

⑥

Vula:

APROVUAR DATË:

⑤ 01.01.2020

Shënim: Qelizat për "Nr. i kuponit" dhe "Aprovuar date", plotësohen nga nepunësi i Degës së Thesarit.

SHPJEGIMI I ELEMENTËVE TË URDHËR SHPENZIMIT, MËNYRA E PLOTËSIMIT TË TIJ SI DHE EKZEKUTIMI I PAGËS SË TË PUNËSUARVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME

I. HYRJE

Urdhër shpenzimi për pagat e të punësuarve, sikurse çdo urdhër shpenzim tjetër i institucionit buxhetor, është dokumenti që pasqyron marrëdhëniet e institucionit me të tretët për detyrimet financiare të lindura mbi bazën e dokumentave justifikues të vërtetuara. Në rastin e urdhër shpenzimit për pagat e të punësuarve, ky dokument pasqyron detyrimin financiar të institucionit buxhetor ndaj të punësuarve të tij, lidhur me detyrimin e pagës neto, pjesë përbërëse e dokumentit të listëpagesës së pagës mujore.

Urdhër shpenzimi për pagat e të punësuarve plotësohet për objekte shpenzimi që i korrespondojnë vetëm një kreditori, të detajuar në mënyrë të hollësishme sipas strukturës buxhetore. Kreditor konsiderohet banka e nivelit të dytë, në të cilën të punësuarit kanë llogarinë e tyre bankare personale. Çdo institucion buxhetor/njësi shpenzuese përgatit një urdhër shpenzim për vlerën totale të pagës neto për çdo bankë të nivelit të dytë, lidhur me të punësuarit të cilët kanë llogarinë e tyre bankare personale në bankën respektive.

Urdhër shpenzimi përbëhet nga katër ndarje si vijon:

- Ndarja e parë përfshin elementët 1 – 13, duke filluar me emërtimin e institucionit dhe duke përfunduar me numrin e punonjësve mbi numrin organik fakt. “Numri i kuponit” përfaqëson numrin unik të transaksionit në SIFQ, i cili plotësohet në urdhër shpenzim pasi ai rregjistrohet për ekzekutim në SIFQ dhe nuk plotësohet nga Nëpunësi Zbatues.

Më hollësisht, në ndarjen e parë përfshihen: “Emri i institucionit”; “NIPT-i i institucionit”; “Kodi i institucionit”, që identifikon kodin unik që ka në thesar; “Entiteti i qeverisjes”, që përdoret për të përcaktuar nivelin e qeverisjes të cilit i përket institucioni (qendrore apo vendore); “Distrikti”, që është kodi unik sipas ndarjes teritoriale; “Numri i kuponit”, që përfaqëson numrin unik të transaksionit në SIFQ, i cili plotësohet në urdhër shpenzim pasi ai rregjistrohet për ekzekutim në SIFQ; “Numri i urdhër shpenzimit”; “Numri unik i transaksionit të faturës elektronike për çdo urdhër shpenzim të prodhuar në sistemin HRMIS”, që plotësohet automatikisht nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit; “Data”, që përfaqëson datën në të cilën ky dokument plotësohet nga institucioni; “Numri i punonjësve të miratuar në organikë” plan dhe fakt; “Numri i punonjësve me kontratë mbi organikë” plan dhe fakt.

- Ndarja e dytë përfshin elementët 14 – 26, duke filluar me numrin rendor, vijuar me strukturën buxhetore, objektin e shpenzimit dhe përfunduar me shumën në lekë totale me fjalë.

Më hollësisht, në ndarjen e dytë përfshihen: “Struktura buxhetore”, që është element që identifikon institucionin në nivel qendror/vendor, varësinë institucionale, natyrën funksionale dhe ekonomike të objektit të shpenzimit dhe që përbëhet nga elementët e strukturës buxhetore: Grup, Kapitull, Program, Llogari Ekonomike, Nënlllogari, Kodi i Projektit/Produktit; “Shuma në lekë”, që shpreh me shifra vlerën neto që i përket objektit të shpenzimit; “Objekti i shpenzimit”, që është përshkrimi i natyrës së shpenzimit të kryer për të cilin kërkohet likuidimi, i cili në rastin e pagave është “Paga për punonjësit

e miratuar në organikë” dhe “Paga e punonjësve me kontratë të përkohëshme mbi organikë”. Totali neto i urdhër shpenzimit për paga, shprehet në shifra dhe me fjalë.

Kodet dhe emërtimet e klasifikimeve buxhetore dhe të llogarive kontabël janë unike për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Theksojmë këtu se, shumat e pagës neto të punonjësve të miratuar në organikë dhe e pagës neto të punonjësve me kontratë të përkohëshme mbi numrin organik, llogaritet nga RQP-ja në varësi të “Kapitullit”, “Kodit të Programit” apo “Kodit të Projektit/Produktit”.

- Ndarja e tretë përfshin elementët 27 – 40, duke filluar me emrin e përfituesit dhe përfunduar me datën e dokumentave bashkëlidhur urdhër shpenzimit.

Më hollësisht, në ndarjen e tretë përfshihen të dhënat për kreditorin përfitues, i cili përfaqëson bankën e nivelit të dytë. Poshtë tij shënohet emërtimi i përfituesit; NIPT-i i kreditorit përfitues; numri i llogarisë në bankë, që është numri i llogarisë tranzitore për pagat e punonjësve, i çelur me urdhër të ministrit përgjegjës për financat; emri i bankës përkatëse, që është e njëjtë me emrin e përfituesit. Në sesionin e “Dokumentave bashkëngjitur” shënohet numri, data dhe lloji i të gjitha dokumentave që justifikojnë objektin e shpenzimit dhe i bashkëngjiten urdhër shpenzimit, që në rastin e pagave të punonjësve është listëpagesa e pagave mujore për të gjithë punonjësit e institucionit dhe listëpagesa për punonjësit e bankës respektive të nivelit të dytë ku urdhërohet për pagesë shpenzimi.

- Ndarja e fundit përfshin elementët 41 – 46, duke filluar me Nëpunësin Autorizues dhe përfunduar me vulën e degës së thesarit.

Më hollësisht, në ndarjen e fundit përfshihen emri dhe nënshkrimi i: (i) “Nëpunësit Autorizues”, i miratuar nga ministri përgjegjës për financat; (ii) “Nëpunësit Zbatues”, i miratuar nga ministri përgjegjës për financat; (iii) Nëpunësit të thesarit, që është specialisti i shpenzimeve të zyrës respektive të thesarit. Urdhër shpenzimi vulolet respektivisht nga institucioni dhe zyra e thesarit.

Urdhër shpenzimi për pagat e punonjësve, i hartuar për vlerën totale neto për çdo bankë të nivelit të dytë, printohet nga RQP-ja së bashku me listëpagesat respektive dhe, pasi nënshkruhet dhe vulolet nga institucioni, dërgohet në zyrën respektive të thesarit për rregjistrim në librin e madh të kontabilitetit në SIFQ dhe ekzekutimin e pagesës në sistemin bankar.

Punonjësi i zyrës së thesarit kontrollon përputhshmërinë e vlerës totale neto të urdhër shpenzimit për pagat e punonjësve me totalin e kolonës së vlerës neto të listëpagesës bashkëlidhur urdhër shpenzimit, si dhe numrin total të punonjësve në listëpagesë, i cili nuk duhet të tejkalojë planin e numrit të punonjësve të miratuar në organikë për institucionin respektiv.

Pas konfirmimit të urdhër shpenzimit për paga nga zyra respektive e thesarit, institucioni dërgon paralelisht pranë bankës respektive të nivelit të dytë, listën e punonjësve sipas formatit të miratuar, bazuar në marrëveshjen që institucioni ka nënshkruar me bankën e nivelit të dytë lidhur me këtë proces.

II. SHPJEGIME MBI URDHËR SHPENZIMIN

TË DHËNAT REFERENCË TË INSTITUCIONIT NË URDHËR SHPENZIM

1. Elementi nr. 1 i urdhër shpenzimit, “Institucioni”

- *Tekst dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (institucioni)!*

Emri i institucionit është i përcaktuar në aktin e krijimit të institucionit (ligj, vendim të Këshillit të Ministrave apo urdhër ministri).

2. Elementi nr. 2 i urdhër shpenzimit, “NIPT- i”

- *Identifikues unik dhe plotësohet nga informacioni me burim Sistemin Informatik Tatimor!*

Numër unik i identifikimit të tatimpaguesit për Entet Publike (qendrore e vendore, si dhe njësitë e zbatimit të projekteve), që krijohet apo regjistrohet tek Drejtoria Rajonale Tatimore pasi është marrë më parë vendimi për krijimin e tyre, në përputhje me legjislacionin e fushës.

Në sistemin RQP plotësohet nga përdoruesi i nivelit të katërt (financieri).

3. Elementi nr. 3 i urdhër shpenzimit, “Kod Institucioni”

- *Numër unik dhe plotësohet nga informacioni me burim Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë!*

Kodi i institucionit buxhetor është kod i standardizuar 7 shifror i njësisë shpenzuese, që përcaktohet nga ministria përgjegjëse për financat/Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe në sistemin RQP plotësohet nga përdoruesi i nivelit të katërt (financieri) nëpërmjet webservis-it (RQP -Thesar).

4. Elementi nr. 4 i urdhër shpenzimit, “Entiteti i Qeverisjes”

- *Numër dhe plotësohet nga informacioni me burim Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë!*

Entiteti i Qeverisjes është element i strukturës buxhetore që tregon nivelin e qeverisjes të cilit i përket institucioni (qeverisje qendrore apo vendore) dhe në sistemin RQP plotësohet nga përdoruesi i nivelit të katërt nëpërmjet webservis-it (RQP -Thesar).

5. Elementi nr. 5 i urdhër shpenzimit, “Distrikti (TDO)”

- *Numër dhe plotësohet nga informacioni me burim Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë!*

Kodi i ndarjes territoriale është element i strukturës buxhetore dhe në sistemin RQP plotësohet nga përdoruesi i nivelit të katërt (financieri) nëpërmjet webservis-it (RQP -Thesar).

6. Elementi nr. 6 i urdhër shpenzimit, “Numri i Kuponit”

- *Numër dhe plotësohet nga nëpunësi i degës së thesarit ose institucioni me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ!*

Numri i kuponit plotësohet nga nëpunësi i degës së thesarit ose institucioni me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ dhe përfaqëson numrin që gjenerohet automatikisht nga sistemi i thesarit për këtë urdhër shpenzim.

7. Elementi nr. 7 i urdhër shpenzimit, “Numri”

- *Numër dhe plotësohet nga nëpunësi i financës!*

Numër që vendoset nga financieri i institucionit për urdhër shpenzimin, i cili fillon me 1 dhe vazhdon në mënyrë progresive brenda vitit.

8. Elementi nr. 8 i urdhër shpenzimit, “Numri identifikues i transaksionit të faturës elektronike”

- *Numër unik dhe plotësohet automatikisht nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (moduli i pagave)!*

Numër unik i transaksionit të faturës elektronike për çdo urdhër shpenzim, që gjenerohet automatikisht nga sistemi RQP.

9. Elementi nr. 9 i urdhër shpenzimit, “Data”

- *Datë dhe plotësohet nga nëpunësi i financës!*

Data e përgatitjes së urdhër shpenzimit.

10. Elementi nr. 10 i urdhër shpenzimit, “Plan”

- *Numër dhe plotësohet automatikisht nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (moduli organika)!*

Numri i punonjësve të miratuar në organikë “plan” përfaqëson numrin e pozicioneve të punës së institucionit, sipas strukturës dhe organikës së miratuar për atë institucion.

Kujdes:

Ky numër në çdo rast është brenda numrit të punonjësve të miratuar në tabelën 2, të ligjit vjetor të buxhetit për institucionet qendrore, i cili detajohet për çdo institucion në aktet e miratimit të strukturave dhe organikave të tyre.

11. Elementi nr. 11 i urdhër shpenzimit, “Fakt”

- *Numër dhe plotësohet automatikisht nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (moduli punonjës)!*

Numri i punonjësve të miratuar në organikë “fakt”, përfaqëson numrin e punonjësve të emëruar në strukturën dhe organikën e miratuar të institucionit.

12. Elementi nr. 12 i urdhër shpenzimit, “Plan”

- *Numër dhe plotësohet automatikisht nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (moduli organika)!*

Numri i punonjësve mbi numrin organik (me kontratë) “plan” përfaqëson numrin e pozicioneve të punës mbi numrin organik të institucionit të miratuar me akte nënligjore.

13. Elementi nr. 13 i urdhër shpenzimit, “Fakt”

- *Numër dhe plotësohet automatikisht nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (moduli punonjës)!*

Numri i punonjësve mbi numrin organik (me kontratë) “fakt”, përfaqëson numrin e punonjësve të emëruar në pozicionet me kontratë të përkohëshme mbi numrin organik të institucionit.

TË DHËNAT FINANCIARE EKONOMIKE NË URDHËR SHPENZIM

14. Elementi nr. 14 i urdhër shpenzimit, “Numër”

- *Numër rendor sekuencial dhe plotësohet automatikisht nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (moduli i pagave)!*

15. Elementi nr. 15 i urdhër shpenzimit, “Grupi ”

- *Numër dhe plotësohet nga informacioni me burim Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë!*

“Grupi” është element i strukturës buxhetore që përfaqëson kodifikimin e klasifikimit buxhetor e kontabël të një institucioni të qeverisjes qendrore/vendore, përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit në tabelat përbërëse të tij dhe gjenerohet nga SIFQ-i.

Në sistemin RQP plotësohet nga nëpunësi i financës nëpërmjet webservis-it (RQP -Thesar).

16. Elementi nr. 16 i urdhër shpenzimit, “Kapitulli”

- *Numër dhe plotësohet nga informacioni me burim Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë!*

“Kapitulli” është element i strukturës buxhetore i gjeneruar nga SIFQ-i, përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit në tabelat përbërëse të tij dhe ka të bëjë me kodifikimin e klasifikimit buxhetor e kontabël lidhur me burimin e financimit.

Në sistemin RQP plotësohet nga nëpunësi i financës nëpërmjet webservis-it (RQP -Thesar).

17. Elementi nr. 17 i urdhër shpenzimit, “Kodi i Programit”

- *Numër dhe plotësohet nga informacioni me burim Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë!*

“Kodi i Programit” është element i strukturës buxhetore i gjeneruar nga SIFQ-i, përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit, në tabelat përbërëse të tij dhe ka të bëjë me kodifikimin e klasifikimit buxhetor e kontabël të veprimtarisë së institucionit.

Në sistemin RQP plotësohet nga nëpunësi i financës nëpërmjet webservis-it (RQP -Thesar).

Referuar ligjit 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, programi buxhetor është një grup veprimtarish të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, që administrohen efektivisht dhe kontribuojnë së bashku në prodhimin e produkteve të identifikueshme dhe të matshme, të cilat ndihmojnë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në arritjen e objektivave dhe të qëllimeve të politikës buxhetore të tij.”.

18. Elementi nr. 18 i urdhër shpenzimit, “Llogaria Ekonomike”

- *Numër dhe plotësohet nga informacioni me burim Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë!*

“Llogaria Ekonomike” është element i strukturës së llogarive ekonomike. Është kod në nivel 3 shifror i gjeneruar nga SIFQ-i dhe që ka të bëjë me kodifikimin e klasifikimit ekonomik dhe identifikon klasën e shpenzimit në planin e llogarive.

Në sistemin RQP (moduli pagë) plotësohet nga nëpunësi i financës.

19. Elementi nr. 19 i urdhër shpenzimit, “Nën Llogaria”

- *Numër dhe plotësohet nga informacioni me burim Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë!*

“Nën Llogaria” është një nënndarje e klasës respektive të shpenzimit në nivel 7 shifror e gjeneruar nga SIFQ-i dhe që tregon llojin e shpenzimit brenda klasës respektive të tij.

Në sistemin RQP (moduli pagë) plotësohet nga nëpunësi i financës.

20. Elementi nr. 20 i urdhër shpenzimit, “Kod Projekti”

- *Numër dhe plotësohet nga informacioni me burim Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë!*

“Kod Projekti/Produkti” është element i strukturës buxhetore i gjeneruar nga SIFQ-i dhe që ka të bëjë me kodifikimin e klasifikimit buxhetor e kontabël të rezultateve/output-eve të përfituara nga veprimtaria e institucionit.

Në sistemin RQP plotësohet nga nëpunësi i financës nëpërmjet webservis-it (RQP -Thesar).

Sipas LOB: “Produkte” janë mallrat dhe shërbimet e siguruara nga kryerja e veprimtarive buxhetore të programit buxhetor”.

21. Elementi nr. 21 i urdhër shpenzimit, “Shuma në lekë”

- *Element me vlerë numerike, llogaritet nga Regjistri Qendror i Personelit (moduli i pagave)!*

“Shuma në lekë” llogaritet në sistemin RQP (moduli i pagave), bazuar në elementët e strukturës buxhetore të institucionit.

22. Elementi nr. 22 i urdhër shpenzimit, “Objekti i Shpenzimit”

- *Tekst dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (moduli i pagave)!*

“Objekti i Shpenzimit” është përshkrimi i natyrës së shpenzimit të kryer, për të cilin kërkohet likuidimi, i cili në rastin e pagave është “Paga neto për punonjësit e miratuar në organikë” dhe “Paga neto e punonjësve me kontratë të përkohëshme mbi numrin organik”.

23. Grupi elementëve nr. 23 të urdhër shpenzimit, “Paga neto për punonjësit e miratuar në organikë”

- *Element me vlerë numerike, llogaritet nga Regjistri Qendror i Personelit (moduli i pagave)!*
- *Referohet me kolonen 32 të listëpagesës mujore të pagave*

Shuma e “pagës neto” për të punësuarit e miratuar në organikë që paguhet në bankën e nivelit të dytë, për të cilën po gjenerohet urdhër shpenzimi.

24. Grupi elementëve nr. 24 të urdhër shpenzimit, “Paga neto e punonjësve me kontratë të përkohëshme mbi numrin organik”

- *Element me vlerë numerike, llogaritet nga Regjistri Qendror i Personelit (moduli pagave)!*
- *Referohet me kolonën 32 të listëpagesës mujore të pagave*

Shuma e “pagës neto” për të punësuarit me kontratë të përkohëshme mbi numrin organik që paguhet në bankën e nivelit të dytë, për të cilën po gjenerohet urdhër shpenzimi.

25. Elementi nr. 25 i urdhër shpenzimit, “Totali në Shifra”

- *Element me vlerë numerike, llogaritet nga Regjistri Qendror i Personelit (moduli i pagave)!*

Shuma e elementeve 23 dhe 24 të urdhër shpenzimit për të gjithë të punësuarit që paguhet në bankën e nivelit të dytë, për të cilën po gjenerohet urdhër shpenzimi.

26. Elementi nr. 26 i urdhër shpenzimit, “Totali me fjalë”

- *Tekst, plotësohet automatikisht nga Regjistri Qendror i Personelit (moduli pagave)!*

Vlera numerike e “Totalit në Shifra” e shprehur në fjalë për të gjithë të punësuarit që paguhet në bankën e nivelit të dytë, për të cilën po gjenerohet urdhër shpenzimi.

TË DHËNAT PËR TRANSFERTAT NË BANKAT E NIVELIT TË DYTË

27. Elementi nr. 27 i urdhër shpenzimit “Emri i përfituesit”

- *Tekst dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit!*

Reflektohet automatikisht emri i plotë i institucionit përfitues nga RQP-ja.

28. Elementi nr. 28 i urdhër shpenzimit, “NIPT-i”

- *Tekst dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit!*

Reflektohet automatikisht NIPT-i i institucionit përfitues nga RQP-ja.

29. Elementi nr. 29 i urdhër shpenzimit, “Numri i llogarisë bankare”

- *Tekst dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit!*

Reflektohet automatikisht nga RQP-ja “Numri i llogarisë bankare” të bankës së nivelit të dytë, ku do të dërgohen pagat e të punësuarve.

30. Elementi nr. 30 i urdhër shpenzimit, “Emri i Bankës”

- *Tekst dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit!*

Reflektohet automatikisht nga RQP-ja emri i bankës së nivelit të dytë, ku marrin pagën të punësuarit që përfshihen në urdhër shpenzim.

31. Elementi nr. 31 i urdhër shpenzimit, “Adresa e Bankës”

- *Tekst dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit!*

Reflektohet automatikisht nga RQP-ja adresa e bankës së nivelit të dytë, ku u marrin pagën të punësuarit që përfshihen në urdhër shpenzim.

32. Elementi nr. 32 i urdhër shpenzimit, “IBAN”

- *Numër dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit!*

Kombinim i numrave dhe gërmave që reflektohet automatikisht nga RQP-ja. Këtu vendoset IBAN i llogarisë tranzitore të pagave në bankë.

33. Elementi nr. 33 i urdhër shpenzimit, “Nr. Dokumenti”

- *Kjo fushë nuk plotësohet në rastin e urdhër shpenzimit për pagat!*

34. Elementi nr. 34 i urdhër shpenzimit, “Datë Dokumenti”

- *Kjo fushë nuk plotësohet në rastin e urdhër shpenzimit për pagat!*

35. Elementi nr. 35 i urdhër shpenzimit, “Nr. Dokumenti”

- *- Kjo fushë nuk plotësohet në rastin e urdhër shpenzimit për pagat!*

36. Elementi nr. 36 i urdhër shpenzimit, “Datë Dokumenti”

- *Kjo fushë nuk plotësohet në rastin e urdhër shpenzimit për pagat!*

37. Elementi nr. 37 i urdhër shpenzimit, “Nr. Dokumenti”

- *Numër dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (moduli i pagave)!*

Plotësohet automatikisht nga RQP-ja me numrin unik të listëpagesës mujore të pagave, dokument i cili i bashkëngjitet urdhër shpenzimit.

38. Elementi nr. 38 i urdhër shpenzimit, “Datë Dokumenti”

- *Numër dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (moduli i pagave)!*

Plotësohet automatikisht nga RQP-ja me datën e listëpagesës mujore të pagave, dokument i cili i bashkëngjitet urdhër shpenzimit.

39. Elementi nr. 39 i urdhër shpenzimit, “Nr. Dokumenti”

- *Numër dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (moduli i pagave)!*

Plotësohet automatikisht nga RQP-ja me numrin unik të listëpagesës për punonjësit e bankës respektive të nivelit të dytë, ku urdhërohet për pagesë shpenzimi, dokument i cili i bashkëngjitet urdhër shpenzimit.

40. Elementi nr. 40 i urdhër shpenzimit, “Datë Dokumenti”

- *Numër dhe plotësohet nga informacioni me burim Regjistrin Qendror të Personelit (moduli i pagave)!*

Plotësohet automatikisht nga RQP-ja me datën e listëpagesës për punonjësit e bankës respektive të nivelit të dytë, ku urdhërohet për pagesë shpenzimi, dokument i cili i bashkëngjitet urdhër shpenzimit.

INFORMACIONI PËR AUTORIZUESIT E URDHËR SHPENZIMIT

41. Elementi nr. 41 i urdhër shpenzimit, “Nëpunësi Autorizues”

- *Tekst dhe plotësohet nga nëpunësi i financës!*

Vendoset Emër Mbiemër i Nëpunësit Autorizues të institucionit dhe firma (autoriteti që ka depozituar firmën në degën e thesarit si nëpunës autorizues).

42. Elementi nr. 42 i urdhër shpenzimit, “Nëpunësi Zbatues”

- *Tekst dhe plotësohet nga nëpunësi i financës!*

Vendoset Emër Mbiemër i Nëpunësit Zbatues të institucionit dhe firma (autoriteti që ka depozituar firmën në degën e thesarit si nëpunës zbatues).

43. Elementi nr. 43 i urdhër shpenzimit, “Vula”

- *Vula dhe plotësohet nga institucioni!*

Vendoset vula institucionit.

44. Elementi nr. 44 i urdhër shpenzimit, “Nëpunësi i Thesarit”

- *Tekst dhe plotësohet nga nëpunësi i degës së thesarit!*

Vendoset Emër Mbiemër dhe firma e nëpunësit të thesarit që pranon urdhër shpenzimin.

45. Elementi nr. 45 i urdhër shpenzimit, “Aprovuar Datë”

- *Datë dhe plotësohet nga nëpunësi i degës së thesarit!*

Vendoset data e aprovimit të urdhër shpenzimit nga nëpunësi i thesarit.

46. Elementi nr. 46 i urdhër shpenzimit, “Vula”

- *Plotësohet nga nëpunësi i degës së thesarit!*

Vendoset vula degës së thesarit, ku bëhet pranimi i urdhër shpenzimit.

PROCEDURA E PUNËS QË DO TË NDIQET PËR REALIZIMIN E PROCESIT TË LLOGARITJES SË PAGAVE DHE GJENERIMIT TË URDHËR SHPENZIMEVE, NË PËRPTHJE ME METODOLOGJINË E PËRLLOGARITJES SË PAGAVE TË PUNONJËSVE BUXHETORË DHE RREGULLAT E EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT TË SHETIT

LISTËPAGESA MUJORE E PAGAVE

1. Përpara se të fillojnë procesin për llogaritjen e pagave të të punësuarve për çdo periudhë page, nëpunësit e financës të njësive shpenzuese që kanë akses të drejtpërdrejtë në RQP, duhet të sigurohen që janë reflektuar të gjitha ndryshimet e të punësuarve në Regjistrin Qendror të Personelit.
2. Për çdo periudhë page, nëpunësit e financës të njësive shpenzuese që kanë akses të drejtpërdrejtë në RQP, sigurohen që janë reflektuar saktë kodet e thesarit për të punësuarit në pozicionet që kanë kode programi/projekti/produkti të ndryshme.
3. Për çdo periudhë page, nëpunësit e financës të njësive shpenzuese që kanë akses të drejtpërdrejtë në RQP, iniciojnë procesin e llogaritjes së pagave për periudhën paraardhëse për pagat e të punësuarve që menaxhohen në këtë sistem, duke kryer veprimin “Hap periudhë page për institucionin”.
4. Për çdo periudhë page, nëpunësit e financës të njësive shpenzuese që kanë akses të drejtpërdrejtë në RQP, sigurohen që nëpunësi i njësisë së burimeve njerëzore të institucionit ka plotësuar listëprezencën, së bashku me detajet e lejeve, raporteve dhe mungesave.
5. Për çdo periudhë page, nëpunësit e financës të njësive shpenzuese që kanë akses të drejtpërdrejtë në RQP, kujdesen të plotësojnë elementët e pagës:
 - shtesat dhe korrektimet mbi pagën bruto të të punësuarve;
 - përjashtimet nga tatimi mbi të ardhurat personale të të punësuarve;
 - ndalesat dhe korrektimet mbi pagën neto të të punësuarve;
 - mbajtjet nga paga neto mujore për efekt të deyrimeve në legjislacione të tjera specifike.
6. Për çdo periudhë page, nëpunësit e financës të njësive shpenzuese që kanë akses të drejtpërdrejtë në RQP, përmes modulit të pagave:
 - “Gjenerojnë” listëpagesën mujore të pagave;
 - “Gjenerojnë” listëpagesën mujore plus (për institucionet të cilat kanë të punësuar që preken nga mbajtjet në pagën neto mujore, për efekt të deyrimeve në legjislacione të tjera specifike);
 - “Aprovojnë” listëpagesat mujore të pagave;
 - “Shkarkojnë” listëpagesat mujore të pagave.
7. Vetëm me përfundimin me sukses të aprovimit të listëpagesës mujore të pagave, nëpunësit e financës mund të vazhdojnë punën për gjenerimin e urdhër shpenzimeve.

URDHËR SHPENZIMI

8. Për çdo periudhë page, nëpunësit e financës të njësive shpenzuese që kanë akses të drejtpërdrejtë në RQP, përgatisin për muajin paraardhës informacionin e nevojshëm elektronik të urdhër shpenzimeve për pagat e të punësuarve respektivë që menaxhohen në këtë sistem.
9. Për çdo periudhë page, nëpunësit e financës të njësive shpenzuese që kanë akses të drejtpërdrejtë në RQP, janë përgjegjës për saktësinë e informacionit elektronik për çdo urdhër shpenzim, i cili përmban të dhënat për:
 - strukturën buxhetore ku do të kryhet shpenzimi për paga;
 - shumën totale neto të pagave të të punësuarve;
 - referencat e llogarisë bankare tranzitore të pagave të të punësuarve në bankën respektive të nivelit të dytë, të çelura për këtë qëllim.
10. Informacioni i listëpagesës përpunohet automatikisht nga RQP-ja (moduli pagë) dhe gjeneron urdhër shpenzimet për çdo bankë të nivelit të dytë.
11. Informacioni elektronik për pagat organizohet në aq urdhër shpenzime sa janë bankat e nivelit të dytë, me të cilat njësia shpenzuese ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për ekzekutimin e pagesës së pagave të të punësuarve.
12. Për çdo periudhë page, nëpunësit e financës të njësive shpenzuese që kanë akses të drejtpërdrejtë në RQP, përmes modulit të pagave:
 - “Aprovojnë” urdhër shpenzimet për çdo bankë;
 - “Shkarkojnë” urdhër shpenzimet dhe transfertat bankare për çdo bankë;
 - “Dërgojnë Elektronikisht” urdhër shpenzimet për çdo bankë, në sistemin SIFQ përmes webservis-it.

Kujdes

Në asnjë rast informacioni elektronik mbi pagat e të punësuarve me burim Regjistrin Qendror të Personelit (moduli pagë) nuk modifikohet në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë!

13. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit (në qendër) bëhet importimi i informacionit elektronik nga sistemi RQP në sistemin SIFQ, bazuar në manualin e punës për këtë proces.
14. Pas importimit me sukses të informacionit nga sistemi RQP në sistemin SIFQ, dega respektive e thesarit thërret informacionin elektronik me burim RQP-në mbi pagat e të punësuarve të juridiksionit të saj, bazuar në manualin e punës për këtë proces.
15. Në rastin e njësive buxhetore me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ, procesi më sipër kryhet nga vetë njësia shpenzuese në SIFQ, pa qenë e nevojshme ndërhyrja e degës respektive të thesarit.
16. Në rastet kur pagat e të punësuarve të një njësie shpenzuese janë të buxhetuara tek një njësi tjetër shpenzuese, atëherë urdhër shpenzimi elektronik i pagave të të punësuarve me burim RQP-në do të përmbajë strukturën buxhetore (përfshirë kodin e institucionit) të njësisë shpenzuese ku është bërë buxhetimi i këtij shpenzimi. Është detyrë e njësisë shpenzuese të njoftojë administratorin e sistemit RQP, me qëllim kryerjen e konfigurimeve të nevojshme në këtë sistem për këto raste.

17. Pas realizimit me sukses të kontrolleve automatike gjatë importimit në SIFQ të informacionit elektronik me burim RQP-në, urdhër shpenzimi elektronik i pagave të të punësuarve shfaqet për vlerësim të fondeve buxhetore të vlefshme dhe aprovim në modulën e të pagueshmeve në SIFQ, në nivelin e degës përkatëse të thesarit me të cilën operon njësia shpenzuese e qeverisjes së përgjithshme, ose tek vetë njësia shpenzuese në rastin kur këto të fundit kanë akses të drejtpërdrejtë në SIFQ për ekzekutimin e buxhetit të tyre. Më pas, dega e thesarit kryen operacionet e mëtejshme në SIFQ, deri në ekzekutimin e pagesës së shpenzimit të pagave të të punësuarve në sistemin bankar të pagesave, sipas procedurës së sistemit të thesarit.
18. Nëpërmjet webservis-it, sistemi RQP do të njohë statusin e ekzekutimit të urdhër shpenzimit elektronik të pagave të të punësuarve, nga SIFQ-i.
19. Shkëmbimi automatik i informacionit elektronik midis RQP-së dhe SIFQ lidhur me procesin objekt të këtij udhëzimi, do të bëhet bazuar në formatet elektronike të testuara dhe pranuar mes palëve.

PROCEDURA NË RAST TË SHFAQJES SË PROBLEMEVE

20. Në rast të dështimit të importimit të informacionit elektronik nga sistemi RQP në sistemin SIFQ, ky i fundit nëpërmjet webservis-it njofton sistemin RQP mbi natyrën e gabimit për transaksionin respektiv dhe:
 - Për gabimet me burim sistemin RQP, nëpunësit e financës të njësive shpenzuese kryejnë veprimet e nevojshme për zgjidhjen e problemit;
 - Për gabimet me burim sistemin SIFQ, Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit (në qendër) kryen veprimet e nevojshme për zgjidhjen e problemit.

Nëpunësit e financës të njësive shpenzuese që kanë akses të drejtpërdrejtë në Regjistrin Qendror të Personelit (moduli i pagave), në përfundim të të gjitha veprimeve të nevojshme për korrektimin e informacionit në RQP, ose pasi kanë konfirmimin nga Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit për zgjidhjen e problematikës, duhet të dërgojnë përsëri në SIFQ informacionin e ri lidhur me urdhër shpenzimin.

21. Nëse urdhër shpenzimi elektronik i pagave të të punësuarve me burim RQP-në, dështon për shkak të mungesës së fondeve të vlefshme buxhetore në SIFQ, atëherë dega e thesarit njofton menjëherë njësinë shpenzuese respektive, e cila merr masat e nevojshme me qëllim sigurimin e vlefshmërisë së fondeve buxhetore.

Në këto raste, njësitë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme njoftohen në RQP për statusin e transaksionit.

22. Nëse mungesa e fondeve të vlefshme buxhetore në SIFQ, është rrjedhojë e strukturës së gabuar buxhetore të përcaktuar në sistemin RQP, (strukturat që njihen të vlefshme në SIFQ, por nuk përdoren për buxhetim pagash), atëherë dega e thesarit nënshkruan një procesverbal me njësinë shpenzuese respektive për këtë qëllim dhe fshin nga SIFQ-i faturën elektronike me burim RQP-në, në të cilën struktura buxhetore është e gabuar.

Më pas, njësia shpenzuese respektive krijon në RQP dhe dërgon në SIFQ, urdhër shpenzimin elektronik me strukturë të saktë buxhetore.

23. Nëse në mbyllje të periudhës kontabile, urdhri elektronik i shpenzimit i krijuar në SIFQ me burim RQP-në nuk është vlerësuar dhe aprovuar (për motivet më sipër) deri në nivelin e fundit të thesarit, atëherë vetë njësia shpenzuese me akses direkt në SIFQ dhe dega e thesarit (pas nënshkrimit të një procesverbali me njësinë respektive shpenzuese) fshijnë urdhër shpenzimin elektronik me burim RQP-në, nga moduli i të pagueshmeve në SIFQ, me qëllim mospengimin e mbylljes së periudhave kontabile në SIFQ. Në këtë rast, njësitë e qeverisjes së përgjithshme njoftohen në RQP për statusin e transaksionit.
24. Në rastet e kthimit të plotë, ose të pjesshëm të pagesave të pagave të të punësuarve nga sistemi bankar, dega e thesarit njofton njësinë shpenzuese respektive për kthimin e pagesës dhe arsyen e kthimit të saj. Më pas, njësia shpenzuese, sipas rastit, inicion rikrijimin dhe ridërgimin e informacionit elektronik të pagave të të punësuarve nga RQP-ja në SIFQ, për vlerën e plotë ose të pjesshme të pagesës me korrigjimet e nevojshme.
25. Nëpërmjet webservis-it, sistemi RQP do të njohë statusin e ekzekutimit të urdhër shpenzimit elektronik të pagave të të punësuarve, nga SIFQ-i.
26. Në rastet kur ndryshon kodi ose NIPT-i i njësisë shpenzuese, atëherë njësia shpenzuese nuk do të krijojë urdhër shpenzimin elektronik të pagave të të punësuarve me burim RQP-në, pa marë më parë konfirmimin që këto ndryshime janë pasqyruar edhe në SIFQ.
27. Pas konfirmimit mbi aprovimin e urdhër shpenzimit elektronik në SIFQ nga dega përkatëse e thesarit, njësia shpenzuese prodhon nga sistemi RQP dhe dërgon në bankën respektive të nivelit të dytë, informacionin e nevojshëm për realizimin e transfertës së pagës, nga llogaria bankare tranzitore, në llogaritë bankare personale të të punësuarve.
28. Deri në një udhëzim të dytë, njësia shpenzuese e qeverisjes së përgjithshme do të dërgojë paralelisht për miratim në degën përkatëse të thesarit, edhe urdhër shpenzimin në dokument fizik të printuar nga RQP-ja. Degat e thesarit e kontrollojnë urdhër shpenzimin si dokument fizik me urdhër shpenzimin elektronik të pagave me burim RQP-në.